

VENDIM
Nr. 619, datë 29.10.2025

PËR KALIMIN TE BASHKIA TIRANË TË NJËSIVE TË BANIMIT NË
NDËRTESA (PALLAT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Tiranë të 143 (njëqind e dyzet e tre) apartamenteve, në 2 (dy) ndërtesa me njësi banimi (pallat), përkatësisht, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA E INVENTARIT TË OBJEKTEVE TË PËRFUNDUARA NË ZONËN "KOMBINAT" , TË KOLAUDUARA

Nr.	Emërtimi i Kontratës	Vlera e Objektit sipas Kontratës (Ndërtim+Montim+Projektim)	Vlera e Situacionit Përfundimtar (Ndërtim+Montim)	Vlera e Studim Projektimit	Vlera e Mbikqyrjes së Punimeve	Vlera e Kolauditimit të Punimeve	Vlera Totale	Sipërfaqe Banimi Bruto Ap. (m2)	Ap.1+1	Ap.2+1	Ap.3+1	Total Apartamente (Nr)
1	Banesë kolektive Godina 6 (Seksioni A)	479,484,400	471,741,147	7,564,732	3,350,000	89,000	482,744,879	6,974.64	24	32	7	63
2	Banesë kolektive Godina 7 (Seksioni C)	545,389,829.90	536,786,332.91	8,603,496	3,872,000	105,000	549,366,829	8,346.25	40	25	15	80